



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Tiranë, më 7 Qershor 2021

KËRKESË PËR SHPREHJE INTERESI

OFICER PËR KOMUNIKIMIN DHE MENAXHIMIN E RRJETEVE SOCIALE

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) rihap thirrjen për angazhimin e një oficeri komunikimi dhe vizibiliteti, i cili duhet të jetë i/e gatshëm të sigurojë komunikimin dhe informimin në lidhje me vizibilitetin e aktiviteteve të projekteve që KShH ka në zbatim. Oficeri i komunikimit bazuar në kërkesat dhe të dhënat e vendosura në dispozicion nga stafi zbatues i KShH, do të përmbushë shërbimet e mëposhtme:

1. Sigurohet komunikimi dhe menaxhimi i rrjeteve sociale në lidhje me vizibilitetin e aktiviteteve në zbatim të projektet të KShH-së.
2. Të zhvillojë një plan komunikimi dhe vizibiliteti, si dhe të ofrojë rekomandime për kanalet e mundshme të komunikimit dhe mjetet e vizibilitetit që do të përdoren nga projektet. Mbi bazën e këtij plani komunikimi dhe vizibiliteti duhet të hartohet linja e brendshme e komunikimit të secilit projekt dhe linja e jashtme e komunikimit më konkretisht: (1) Projekt – Palë e interesit; (2) Projekt – Donator; (3) Projekt – Media & Publiku i gjerë.
3. Gjithashtu, do të ofrohen rekomandime në hartimin e materialeve të nevojshme për të siguruar që komunikimi i projektit është në përputhje me udhëzimet e donatorëve dhe mbështetësve të iniciativave përkatëse.
4. Në pajtim me planin e komunikimit dhe vizibilitetit, do të përgatisë rekomandime për implementimin e aktiviteteve, me fokus të veçantë sfidat e paraqitura nga pandemia globale Covid-19 ose nga fatkeqësi të tjera natyrore.
5. Të elaborojë dhe të përditësojë website dhe profilet e rrjeteve sociale të organizatës në Facebook, instagram etj.
6. Të elaborojë dizajnin dhe të ofrojë rekomandime në rastet e prodhimit të materialeve për vizibilitetin e projekteve. Më konkretisht, duhet të kontribuojë në përgatitjen e materialeve të vizibilitetit si psh, postime në median sociale dhe në faqen zyrtare, intervista/artikuj në median e shkruar dhe elektronike, infografikë, etj, në bashkëpunim me stafin e KShH.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

7. Për më tepër oficeri i angazhuar do të mbështesë në implementimin e planit të komunikimit dhe vizibilitetit dhe linjave të hartuara paraprakisht prej tij/saj, si dhe do të ndërmarrë aktivitetet mbështetëse siç kërkohet.

Pozicioni i punës nuk kërkon prani fizike në zyrë, pra mund të kryhet remotely dhe part-time. Vetëm në raste përjashtimore mund të kërkohet prania në zyrë për 2-3 ditë pune. Oficeri/ja duhet të hartojë një raport pune 1 herë në javë (çdo ditë të premte), dhe do ia adresojë administratorit të zyrës të KShH-së, i/e cili/a pas vlerësimit e përcjell për miratim pranë koordinatorëve të projekteve respektive. Ky raport do të përfshijë një përshkrim të detajuar të të gjitha aktiviteteve dhe rezultateve të arritura në kontekst të detyrave të përcaktuara për oficerin/en.

Periudha për të cilën oficeri i medias kërkohet të angazhohet në këtë projekt është **18 muaj**.

KShH inkurajon aplikimet nga kandidatë, të cilët janë të interesuar për t'u angazhuar si oficerë në këtë proces dhe plotësojnë këto kritere të aftësisë individuale, edukimit dhe aftësisë profesionale në vijim:

Aftësitë individuale

1. Të jetë i/e pavarur, i/e paanshëm dhe me integritet;
2. Të ketë aftësi shumë të mira komunikimi dhe bashkëpunimi në ekip dhe jo vetëm;
3. Të ketë aftësi analitike dhe mendim kritik;
4. Të jetë i/e përgjegjshëm për respektimin e detyrave dhe afatet e vendosura;
5. Të ketë aftësi të punojnë nën presionin e kohës.

Edukimi dhe aftësitë profesionale

1. Të zotërojë diplomë në nivelin Bachelor/ Master, mundësisht në fusha që lidhen me marrëdhëniet me publikun, politikat dhe praktikat e komunikimit;
2. Aftësi analitike, ndërpersonale dhe komunikuese;
3. Aftësi në nivelin B2 në gjuhën angleze;
4. Njohuri kompjuterike (aplikacionet MS Office dhe paketat e programit të dizanjit).
5. Të paktën 1 vit përvojë pune në fushën e marrëdhënieve me publikun dhe mediave.
6. Përvojë në zbatimin e aktiviteteve të komunikimit dhe vizibilitetit, në përputhje me pikën 2 të thirrjes.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

KShH inkurajon personat e interesuar që të dërgojnë në formë elektronike në adresën e e-mailit të KShH-së office@ahc.org.al, deri në datën 14.06.2021 dokumentacionin e mëposhtëm (në mënyrë kumulative):

1. CV (Curriculum Vitae);
2. Letër motivimi dhe listë me referenca;
3. Ofertë finaciare të shprehur në Lekë.
4. Dëshmi ku vërtetohet njohuria e gjuhës angleze.
5. Një folder me punime të mëparshme dizajni si postera, infografikë etj.

Vetëm oficeri i përzgjedhur do të njoftohet.

Me konsideratë,
Komiteti Shqiptar i Helsinkit